



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 11 tetor 2012  
Nr. ref.: RK312/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti nr. KI21/11

Parashtruesi

**Valbona Zogaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 329/09, të 3 qershorit 2010, si dhe i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 187/2008, të 30 qershorit 2009**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Ivan Čukalović, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Valbona Zogaj, e cila për momentin është në vuajtje të dënimit me burg në QKP në Lipjan, të cilën në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson avokatja Nushe Kuka-Mekaj nga Peja.

## **Vendimet e kontestuara gjyqësore**

2. Vendimet e kontestuara gjyqësore janë: Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. Nr. 329/09, i 3 qershorit 2010, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 187/2008, i 30 qershorit 2009.

## **Çështja e lëndës**

3. Parashtruesi i kërkesës konsideron se, me vendimet e kontestuara gjyqësore, i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë, e posaçërisht e drejta në mbrojtje përkatëse profesionale në procedurat penale të drejtuara kundër saj.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon që mbrojtësit e saj në procedurë penale e kishin këshilluar gabimisht që të mos e thotë të vërtetën në gjyq. Kështu që, e vërteta nuk është thënë fare në gjyq. Sipas parashtruesit, kjo ishte arsyeja që ajo është konstatuar gabimisht fajtoresh për veprën penale vrasje e rëndë.
5. Parashtruesi i kërkesës pretendon që në procedurë është dashur ta kishte mbrojtjen përkatëse, e posaçërisht në rastet e veprave të rënda penale, duke cekur, siç parashihet me dispozitën e nenit 75.4 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Ajo pohon që nuk ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e veprës penale, ndërsa fshehja e argumenteve të vërteta nga gjyqi ishte e dëmshme për të, si dhe pohon që gjykata ishte e obliguar t'i ofronte mbrojtje përkatëse profesionale në procedurë.
6. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të konstatojë që aktgjykimet e kontestuara janë nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe, prandaj, t'ia mundësojë përsëritjen e procedurës penale para gjykatave të rregullta.

## **Baza ligjore**

7. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe rregulli 36.1 (b) i Rregullores së punës së Gjykatës.

## **Procedura në Gjykatë**

8. Më 18 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
9. Më 2 mars 2011, Kryetari i Gjykatës, me vendimin Nr. GJR. 21/11, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese.
10. Më 7 tetor 2011, Sekretariati i Gjykatës kërkoi nga avokatja e parashtruesit të kërkesës, Nushe Kuka-Mekaj nga Peja, që t'ia dorëzonte Gjykatës edhe kopjen e vendimit të fundit të pranuar gjyqësor, së bashku me fletëdërgesën e nënshkruar në mënyrë të duhur.
11. Më 21 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren ia dorëzoi Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kopjen e nënshkruar në mënyrë të duhur të fletëdërgesës për pranimin e dorëzimit të aktgjykimit të pandehurës, nga e cila vërehet qartë se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar personalisht Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. Nr. 187/08, të 30 qershorit 2009, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Nr. Ap. 329/2009, të 3 qershorit 2010, e cila i është dorëzuar personalisht më 9 korrik 2010.

12. Po të njëjtën ditë, Gjykata e Qarkut në Prizren i dorëzoi Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kopjet e fletëdërgesave, të nënshkruara nga mbrojtësja e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pranimin e aktgjykimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren. Mund të konkludohet që njëri mbrojtës kishte pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 8 korrik 2010, ndërsa tjetri më 9 korrik 2010.
13. Më 2 korrik 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Iliriana Islami.
14. Më 3 korrik 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e shkurtër e fakteve**

15. Më 30 qershor 2009, sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 187/08, parashtruesja është shpallur fajtores dhe është dënuar me 18 vjet heqje lirie për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë sipas nenit 147.1 (4) dhe të veprës penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të armëve sipas nenit 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
16. E pakënaqur më rezultatin e kësaj, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet avokatëve të saj, ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Kodit Penal dhe të aktvendimit për dënim penal. Për më tepër, avokatët mbrojtës të parashtruesit të kërkesës, parashtruan një përgjigje ndaj ankesës së Zyrës së Prokurorit Publik.
17. Më 3 qershor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Ap. Nr. 329/2010, me të cilin e konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe hodhi poshtë ankesat e avokatëve mbrojtës të parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorit Publik të Qarkut si të pabazuara. Gjykata Supreme, në arsyetimin e aktgjykimit, deklaroi, ndër të tjera: “Kjo Gjykatë konstatoi si të pabazuara pohimet ankimore se aktgjykimi i kontestuar ka shkelur Kodin Penal ndaj të pandehurit, sepse nga provat e evidencuara pa asnjë dyshim del se i pandehuri ka kryer vepër penale, për të cilën ajo u shpall fajtores në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të duhur dispozitat e Kodit Penal kur ka sjellë veprimet e të pandehurës në normat ligjore të vrasjes së rëndë sipas nenit 147, paragrafi 1, pika 4, të GJKK...”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili thotë:

*“Afatet*

*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*

18. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e saj, ankohet në shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë, respektivisht se është këshilluar gabimisht gjatë procedurës në gjykatë nga mbrojtësi të cilin vetë e kishte përzgjedhur.
19. Sidoqoftë, Gjykata vëren se aktgjykimi final është nxjerrë më 3 qershor 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësit e saj e kanë pranuar më 8 korrik 2010 dhe më 9 korrik 2010.
20. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 18 shkurt 2011, që do të thotë se kërkesa i është parashtruar Gjykatës jashtë afatit të paraparë gjyqësor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
21. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 26, paragrafi 1 (b), të Rregullores së punës, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 48, 49 e 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës njëzëri:

### **VENDOSI**

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'i komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani